REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 28749/2 Prot

Shkodër, më 11.11.2026

DËRGIM PROJEKT-VENDIM DHE RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltar !
Bashkangjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shpjegues **"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri "**

▶ Ky projekt-vendim dhe relacion përmban këtë dokumentacion:

- *Shkresë përcjellese 1(një) Fletë*
- *Projekt-vendim 3(tre)) Fletë*
- *Relacion 2(dy) Fletë*
- *Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake 2 (dy) Fletë*
- *Preventivi i punimeve Ndërtimore 4 (katër) Fletë*
- *Proçesverbal Konstatimi 2 (dy) Fletë*
- *Planimetri 2 (dy) Fletë*
- *Urdhër Pune 2 (dy) Fletë*
- *Kërkesë Ndihme financiare ne rast djegie banese 2 (dy) Fletë*
- *Vërtetim për rënie zjarri 2 (dy) Fletë*
- *Çertifikatë familjare 2 (dy) Fletë*
- *Saktësim adrese 2 (dy) Fletë*
- *Kartë ID 1(një) Fletë*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SHKODËR

KRYETAR
Bertel BECI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr.28749 Prot Shkodër, më 11.11.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr.28749, datë 11.11.2026

"PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E JAK NIKOLLA DHE GJERGJ NIKOLLA, BANESA E TË CILËVE ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI".

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës _____2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile"; Ligjin nr.68/2017 'Për financat vendore" i ndryshuar; VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKM nr. 414 datë 08.07.2021 " Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar; VKB Nr.84 datë 18.12.2025 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë së Shkodrës"i ndryshuar, VKB Nr.40, datë 30.04.2026 "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 e VKB nr.84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër" i ndryshuar ,si dhe në Relacionin nr_____prot, datë_____e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Jak Nikolla** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (Tetëdhjetë mijë) lekë (sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Jak Nikolla** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej **1 321 990** (Një milion e treqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë dhe për dëmet në orendi prej **365 160** (Treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.

3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Gjergj Nikolla** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (Njëqind mijë) lekë (sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Gjergj Nikolla** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej **1 005 942** (Një milion e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e dy) lekë, dhe për dëmet në orendi prej **299 000** (Dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë,sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.
5. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile i parashikuar në programin **AB141** " Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile" në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026 të miratuar me VKB Nr.84 datë 18.12.2025 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë së Shkodrës"i ndryshuar,në programin **AB141, Q2 O1 A5** " Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie", në vlerën **180 000** (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
6. Për familjet e **Jak Nikolla** dhe **Gjergj Nikolla,** kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit të hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 " Për Mbrojtjen Civile " neni 41 , të VKM-së Nr.329 ,datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së nr. 414 ,datë 08.07.2021 pika 3.1/a " Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile ,i ndryshuar, VKB Nr.40, datë 30.04.2026 "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 e VKB nr.84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masën 50 % të vlerës ndërtimore në shumën **1 163 966 (**Një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë**)** lekë ,dhe në masën 50% të vlerës së orendive në shumën **332 080** (Treqind e tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë) lekë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Benet BECI

- **ZV.KRYETAR**

- **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR**

- **DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR**

- **DREJTORIA E FINANCËS**

- **DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE , BURIMEVE NJEREZORE DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE**

- **DREJTORIA JURIDIKE**

- **DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

Nr.2879/9 Prot Shkodër, më 11.11.2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë!

Në vijim të procedurave për shkak të rënies së zjarrit në banesën e shtetasit: **Jak Nikolla** banor në rrugën "Muriqan-Shtuf", Nd. 108, Hyrja. 1, Nj.Adm.Ana e Malit, dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 23.08.2026, **Gjergj Nikolla** banor në rrugën "Muriqan-Shtuf", Nd. 108, Hyrja. 2, Nj.Adm.Ana e Malit, dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 23.08.2026, bazuar në Ligjin nr. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", V.K.M. nr. 329, datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"*, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

I. Ju paraqesim këtë propozim për dhënie të ndihmës së menjëhershme financiare si më poshtë: Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin AB141 " Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile" në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026 të miratuar me VKB Nr. 84 datë 18.12.2025 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë së Shkodrës" i ndryshuar, në programin AB141.Q2.O1.A5 " Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie", në vlerën **180 000** (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Nr	Emri i kryefamiljarit	Numri i personave sipas certifikatës familjare	Koha kur është djegur ose demtuar banesa	Data e paraqitjes së kërkesës	Ndihma financiare e propozuar
1	Jak Nikolla	4	23.08.2026	19.10.2026	80 000
2	Gjergj Nikolla	5	23.08.2026	27.10.2026	100 000
	Shuma Totale				**180 000**

II. Për familjet e **Jak Nikolla** dhe **Gjergj Nikolla** kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit, hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 " Për Mbrojtjen Civile " neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 pika 3.1/a " Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile, i ndryshuar, VKB Nr.40, datë 30.04.2026 "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 e VKB nr.84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, në masën 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 660 995 (Gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë dhe në masën 50% të vlerës së orendive në shumën 182 580 (Njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë për familjen e **Jak Nikolla,** në masën 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 502 971 (Pesëqind e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) lekë dhe në masën 50% të vlerës së orendive në shumën 149 500 (Njëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë për familjen e **Gjergj Nikolla.**

▶ Tabela e përfitimit sipas dëmeve ndërtimore dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake është:

Nr	Emri familjes	Vlera ndërtimore 1	Vlera e orendive 2	Vlera ndërtimore dhe e orendive 1 + 2	50 % Vlera ndërtimore 4	50 % Vlera e orendive 5	50 % Vlera ndërtimore dhe e orendive 4 + 5	Humbja e jetës 6	Dëmshpërblim për humbje jete 7
1	Jak Nikolla	1 321 990	365 160	1 687 150	660 995	182 580	843 575	-	-
2	Gjergj Nikolla	1 005 942	299 000	1 304 942	502 971	149 500	652 471		
	Shuma përfundimtare	**2 327 932**	**664 160**	**2 992 092**	**1 163 966**	**332 080**	**1 496 046**	**-**	**-**

KRYETAR
Benet BECI

DREJTORI
Xhehnet DANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Numri i praktikës: 18258
Datë: 19/10/2026

KËRKESË

Unë i/e nëshkruari/a Jak Mark Nikolla me numër personal , banues në Muriqan,Shkoder, .

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9355datë 10-03-2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" *të ndryshuar* ,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329 datë 16-05-2012, *"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"* ;

KËRKOJ

Trajtimin me *"Ndihmë financiare në rast djegie banese"*.

Në rast të miratimit të ndihmës financiare, do të kërkoja që pagesa të bëhej në llogarinë time bankare në në llogarinë bankare:
Emri i llogarisë:
Numër ,
IBAN
Bashkëlidhur kam dorëzuar dokumentat e nevojshme.

Aplikanti

Jak Nikolla

Specialisti i zyrës me një ndalesë

Eva Paloka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODER

NJËSIA ADMINISTRATIVE ANE E MALIT

Nr 276 Prot

Ana e Malit më, 27. 08.2026

Lënda : Saktësim adrese

Z. Jak Nikolla

Ne përgjigje të kërkesës së bërë sot më datë 28.08.2026 , bazuar në ligjin nr.139/2015 ''Per veteqeverisjen vendore ''si dhe ligjit nr.9270/2004''Per sistemimin e adresave'' të ndryshuar vërtojmë se **Z. Jak Nikolla**. i datëlindjes 21-06-1943 ,me numër personal ID. **E30602119F** ,është banues në :

Rruga MURIQAN-SHTUF 03370030 ,Ndërtesa 108, Hyrja 1, zona kadastrale 2740, mURIQAN,Ana e Malit Shkoder.

E lëshojmë këtë vërtetim me kërkesen e të interesuarit .

ADMINISTRATORI

Adnan SHULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE ANA E MALIT BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, ëeb: ëëë.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Nr.426/1 Prot

shkodër më 31.08.2026

VËRTETIM

Për rënie zjarri

Vërtetohet se me datë 23.08.2026 ora 11^{50} është djegur Shtëpi banimi 2(dy)katëshe
E mbuluar me çati me tjegulla gjithsej 4(katër) dhoma +koridor
Në adresën: Fshati Muriqan Njësia administrative Ana Malit Shkodër.
Pronësi : Z Jak Nikolla
Si pasojë e zjarrit të rënë janë shkaktuar dëme materiale si vijon më poshtë :
Eshte djegur në katin I^{rë} një dhomë dhe katin e II^{të} një dhomë,si dhe çatia e shtëpisë djege komplet .janë djegur disa materiale shtëpiake si vijon më poshtë; frigorifer copë 1(një),Televizor copë 1(një),komplet divanash copë 1(një),tavolinë buke copë 1(një) karrige copë 6(gjashtë)
Për fikjen e zjarrit ka marrë pjesë përsoneli i stacionit zjarrëfikës,i turnit të I ^{rë}e turnit II^{të},,me komandant turni Kryezjarrëfikës Petrit Nika me mjetin zjarrëfikës Mercedez Benz"me targë AB-114-PP + Iveko 8 ton ,më date 23.08.2026 ora 11^{50} nga ndërhyrja jonë,u bë e mundur shuarja e plotë e zjarrit,dhe mos përhapja e zjarrit në pjesët e tjera të banesave që ishin përreth.
Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin pëkatës që verteton rënien e këtij zjarri.
Ky vertetim mbahet në 3(tre) kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për interesuarve për ta përdorur sipas nevojave.

Shefi Sektorit Ndërhyrjes
Bashkim **RAMAJ**

Drejtori MZSH Shkodër
Agim **PONARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË DREJTORIA E SHËRBIMIT TË MZSH BASHKIA SHKODËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia Shkodër
Njësia administrative Shkodër 332
Zyra e Gjendjes Civile 332

Datë: 19.10.2026

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Jak NIKOLLA	Mark	Lulë	M	Kryefamiljar	21-06-1943	I/e martuar	Muriqan, Shkodër	Shqiptare	E30602119F
2.	Ardiane NIKOLLA	Jak	Drande	F	E Bija	09-05-1972	Beqar/e	Muriqan,Shkoder	Shqiptare	H25509027L
3.	Aleksander NIKOLLA	Jak	Drande	M	I Biri	18-05-1975	I/e divorcuar	Muriqan,Shkoder	Shqiptare	H50518046J
4.	Marjeta NIKOLLA	Jak	Drande	F	E Bija	09-05-1978	Beqar/e	Oblikë, Shkodër	Shqiptare	H85509028C
5.	----------									
6.	----------									
7.	----------									
8.	----------									
9.	----------									
10.	----------									

Kjo certifikatë lëshohet për zyrtare (perberja familjare e dt.23.08.2026)

Përbërja familjare, datë 23.08.2026

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Ylber Tahiri

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Ylber Tahiri

Digitally signed by Ylber Tahiri
Date: 2026.10.19 09:20:43 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

26049
Nr._____ Prot

Shkodër, më 21.10.2026

URDHËR
Nr.1338, datë 21.10.2026

PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË KONSTATIMIT DHE VLERËSIMIT TË DËMEVE NË RASTE TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të Ligjit 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore",neni 8, pika 1 dhe 2, si dhe neni 64, pika a, i këtij ligji, dhe VKM. nr 329 datë 23.05.2012, "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerzore"

URDHËROJ:

I- Ngritjen e grupit të konstatimit të dëmeve në raste fatkeqësish ne lidhje me trajtimin e "Ndihmës financiare në rast djegie banese"për shtetasin :**Jak Mark Nikolla** .

II- Grupi i konstatimit të përbëhet si më poshtë:
1. Kolë Ndrevashaj
2. Besmir Lekaj
3. Suad Mati
4. Administratori Nj. Adm. Ana e Malit.

III- Lëvizja e grupit të punës të koordinohet nga Drejtoria Emergjencave Civile.

IV- Ky urdher hyn në fuqi menjëherë .

KRYETAR
Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
Zv. KRYETAR
Alban BREKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SHKODËR

Besnik Leka
29/10/2026
Për trajtim si pas
ofertë ligjor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Numri i praktikës: 18606
Datë: 27/10/2026

KËRKESË

Unë i/e nëshkruari/a Gjergj Mark Nikolla me numër personal , banues në Rr.Muriqan,Shkoder, .

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9355datë 10-03-2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" *të ndryshuar* ,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329 datë 16-05-2012, *"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"* ;

KËRKOJ

Trajtimin me *"Ndihmë financiare në rast djegie banese".*

Në rast të miratimit të ndihmës financiare, do të kërkoja që pagesa të bëhej në llogarinë time bankare në në llogarinë bankare:
Emri i llogarisë:
Numër ,
IBAN
Bashkëlidhur kam dorëzuar dokumentat e nevojshme.

Aplikanti

Gjergj Nikolla

Specialisti i zyrës me një ndalesë

Bep Kurti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, ëeb: ëëë.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Nr.532/1 Prot

shkodër më 27.10.2026

VËRTETIM

Për rënie zjarri

Vërtetohet se me datë 23.08.2026 ora 11^{50} është djegur Shtëpi banimi 2(dy)katëshe
E mbuluar me çati me tjegulla gjithsej 4(katër) dhoma +koridor
Në adresën: Fshati Muriqan Njësia administrative Ana Malit Shkodër.
Pronësi : Z Gjergj Nikolla
Si pasojë e zjarrit të rënë janë shkaktuar dëme materiale si vijon më poshtë :
Eshte djegur në katin $I^{rë}$ një dhomë dhe katin e $II^{të}$ një dhomë,si dhe çatia e shtëpisë djege komplet .janë djegur disa materiale shtëpiake si vijon më poshtë; Dollap rrobash copë 1(një) ,Televizor copë 1(një),komplet divanash copë 1(një),tavolinë buke copë 1(një) karrige copë 4(kater)
Për fikjen e zjarrit ka marrë pjesë përsonel i stacionit zjarrëfikës,i turnit të I ^{rë}e turnit $II^{të}$,,me komandant turni Kryezjarrëfikës Petrit Nika me mjetin zjarrëfikës Mercedez Benz"me targë AB-114-PP + Iveko 8 ton ,më date 23.08.2026 ora 11^{50} nga ndërhyrja jonë,u bë e mundur shuarja e plotë e zjarrit,dhe mos përhapja e zjarrit në pjesët e tjera të banesave që ishin përreth.
Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin pëkatës që verteton rënien e këtij zjarri.
Ky vertetim mbahet në 3(tre) kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve pë interesuarve për ta përdorur sipas nevojave.

Shefi Sektorit Ndërhyrjes
Bashkim **RAMAJ**

Drejtori MZSH Shkodër
Agim **PONARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODER

NJËSIA ADMINISTRATIVE ANE E MALIT

Nr 371 Prot

Ana e Malit më, 27. 08.2026

Lënda : Saktësim adrese

Z. Gjergj Nikolla

Ne përgjigje të kërkesës së bërë sot më datë 27.08.2026 , bazuar në ligjin nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore "si dhe ligjit nr.9270/2004"Per sistemimin e adresave" të ndryshuar vërtojmë se **Z. Gjergj Nikolla**. i datëlindjes 11-12-1945 ,me numër personal ID. **E51211012D** ,është banues në :

Rruga MURIQAN-SHTUF 03370030 ,Ndërtesa 108, Hyrja 2, zona kadastrale 2740, MURIQAN,Ana e Malit Shkoder.

E lëshojmë këtë vërtetim me kërkesen e të interesuarit .

ADMINISTRATORI

Adnan SHULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE ANA E MALIT BASHKIA SHKODËR


LETËRNJOFTIM ID
REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA
Nikolla
Gjergj
Shqiptare/Albanian
034547370
Murlqan, ALB
11-12-1945
M
05-08-2019
04-08-2029
MPB
E51211012D


I<ALB034547370 9E51211012D<<<<<
4512112M2908041ALB<<<<<<<<<<<4
NIKOLLA<<GJERGJ<<<<<<<<<<<<<<<

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Shkodër

Njësia administrative Shkodër

Zyra e Gjendjes Civile 332

Datë: 26.10.2026

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Gjergj NIKOLLA	Mark	Lulë	M	Kryefamiljar	11-12-1945	I/e martuar	Muriqan, Shkodër	Shqiptare	E51211012D
2.	Roze NIKOLLA	Kin	Kushë	F	Bashkëshorte	20-08-1944	I/e martuar	Dajç Bregu Bunës, Shkodër	Shqiptare	E45820054C
3.	Kledi NIKOLLA	Gjergj	Rozë	M	I Biri	24-08-1979	I/e martuar	Oblikë, Shkodër	Shqiptare	H90824033V
4.	Alma NIKOLLA	Fran	Zojë	F	E Reja	19-10-1983	I/e martuar	Oblikë, Shkodër	Shqiptare	I36019027E
5.	Jeffri NIKOLLA	Kledi	Alma	M	Nipi	19-07-2002	Beqar/e	Silna, Itali	Shqiptare	K20719030L
6.	Kleiton NIKOLLA	Kledi	Alma	M	Nipi	03-06-2012	Beqar/e	Prato(PO), Itali	Shqiptare	L20603052F
7.	----------									
8.	----------									
9.	----------									
10.	----------									

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Përbërja familjare, datë 23.10.2026

Vulosur elektronikisht nga Ministria e Punëve të Brendshme
Date:2026/10/26 14:01:12 +02'00'
503ac37741d54b50be4bbd329b62e1d72026102614011
09801001

Shënim: Ky dokument ka të njëjtin fuqi ligjore dhe vulosuri si ai në formë të shkruar.
(I më pas është automatikisht nga ky sistem elektronik Ministria e Punëve të Brendshme)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

26832
Nr._____ Prot

Shkodër, më 28 10 .2026

URDHËR
Nr.142, datë 28.10.2026

PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË KONSTATIMIT DHE VLERËSIMIT TË DËMEVE NË RASTE TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të Ligjit 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore",neni 8, pika 1 dhe 2, si dhe neni 64, pika a, i këtij ligji, dhe VKM. nr 329 datë 23.05.2012, "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerzore"

URDHËROJ:

I. Ngritjen e grupit të konstatimit të dëmeve në raste fatkeqësish ne lidhje me trajtimin e "Ndihmës financiare në rast djegie banese"për shtetasin :**Gjergj Mark Nikolla** .

II. Grupi i konstatimit të përbëhet si më poshtë:
   1. Kolë Ndrevashaj
   2. Besmir Lekaj
   3. Suad Mati
   4. Administratori Nj.Adm.Ana Malit

III. Lëvizja e grupit të punës të koordinohet nga Drejtoria Emergjencave Civile.

IV. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë .

KRYETAR
Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
Zv. KRYETAR
Alban PREKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA EMERGJECAVE CIVILE

Shkodër, më 22.10.2026

PROÇES VERBAL KONSTATIMI

Mbi gjendjen e banesës së djegur të shtetasit Jak Nikolla në rrugën "Muriqan-Shtuf", Nd. 108, Hyrja.1, Nj.Adm.Ana e Malit, Shkodër.

I mbajtur sot, më datën 22.10.2026 në banesën e shtetasit Jak Nikolla në rrugën "Muriqan-Shtuf", Nd. 108, Hyrja.1, Nj.Adm.Ana e Malit, Shkodër, mbi konstatimin e gjendjes së saj pas dëmeve të shkaktuara nga zjarri i rënë më dt. 23.08.2026 , sipas kërkesës së qytetarit me Nr. Praktike:18258 datë 19.10.2026, mbështetur në VKM.nr. 329, datë 16.05.2012,"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" dhe në zbatim të "Urdhërit të Brendshëm" të Kryetarit të Bashkisë Shkodër me Nr. 1338, datë 21.10.2026,nga verifikimi në vend i gjendjes së banesës ku banon familja e mësipërme në të cilën me datën 23.08.2026 ka rënë zjarr, u konstatua si më poshtë:

Banesa e këtij shtetasi është shtëpi banimi 2(dy) katëshe,e mbuluar me çati e përbërë nga një dhomë gjumi, dhomë ndenje, kuzhine, koridor dhe banjo e banueshme kur ka ndodhur zjarri.

Si rezultat i zjarrit të rënë është djegur plotësisht banesa duke demtuar shtresat e laminateve dhe pllakave, suvatimet dhe lyerjet, tavanet me trarë dërrase, llamarinës dhe pajisjet e orendite brenda: ***Dhomë gjumi matrimoniale copë 1 (një); Komplet divane copë 1(një); Dyshek tek copë 1(një); Minibare copë 1(një); Televizor copë 1(një); Frigorifer copë 1(një); Tavolinë buke copë 1(një); Karrige copë 6(gjashtë).***

Komisioni :

1. Kolë Ndrevashaj
2. Besmir Lekaj
3. Suad Mati
4. Administratori "Nj.Adm.Ana e Malit"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA EMERGJECAVE CIVILE

Shkodër, më 30.10.2026

PROÇES VERBAL KONSTATIMI

Mbi gjendjen e banesës së djegur të shtetasit Gjergj Nikolla në rrugën "Muriqan-Shtuf", Nd. 108, Hyrja.2, Nj.Adm.Ana e Malit, Shkodër.

I mbajtur sot, më datën 22.10.2026 në banesën e shtetasit Gjergj Nikolla në rrugën "Muriqan-Shtuf", Nd. 108, Hyrja.1, Nj.Adm.Ana e Malit, Shkodër, mbi konstatimin e gjendjes së saj pas dëmeve të shkaktuara nga zjarri i rënë më dt. 23.08.2026 , sipas kërkesës së qytetarit me Nr. Praktike:18606 datë 27.10.2026, mbështetur në VKM.nr. 329, datë 16.05.2012,"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" dhe në zbatim të "Urdhërit të Brendshëm" të Kryetarit të Bashkisë Shkodër me Nr. 1421, datë 29.10.2026,nga verifikimi në vend i gjendjes së banesës ku banon familja e mësipërme në të cilën me datën 23.08.2026 ka rënë zjarr, u konstatua si më poshtë:

Banesa e këtij shtetasi është shtëpi banimi 2(dy) katëshe,e mbuluar me çati e përbërë nga një dhomë gjumi, dhomë ndenje, kuzhine, koridor dhe banjo e banueshme kur ka ndodhur zjarri.

Si rezultat i zjarrit të rënë është djegur plotësisht banesa duke demtuar shtresat e laminateve dhe pllakave, suvatimet dhe lyerjet, tavanet me trarë dërrase, llamarinës dhe pajisjet e orendite brenda: ***Dhomë gjumi matrimoniale copë 1 (një); Komplet divane copë 1(një); Dyshek tek copë 1(një); Minibare copë 1(një); Televizor copë 1(një); Tavolinë buke copë 1(një); Karrige copë 4(katër).***

Komisioni :

1. Kolë Ndrevashaj
2. Besmir Lekaj
3. Suad Mati
4. Administratori "Nj.Adm.Ana e Malit"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA EMERGJECAVE CIVILE

Shkodër, më 23.10.2026

MIRATOHET
KRYETARI
BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV. KRYETARI
ALBAN PREKA

Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtëpiake

Në mbështetje të VKM.nr. 329, datë 16.05.2012,"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" vlerësimi i dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për orenditë , mobiljet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në banesën e **Jak Nikolla** është:

Nr	Emertesa	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Dhomë gjumi matrimoniale	1	155,000	155,000
2	Komplet divane	1	41,400	41,400
3	Dyshek tek	1	7,600	7,600
4	Televizor LG 32	1	39,400	39,400
5	Frigorifer Gorenje	1	30,600	30,600
6	Tavoline buke	1	18,000	18,000
7	Karrige	6	1,400	8,400
8	Minibare	1	32,000	32,000
9	Lavatriçe Gorenje	1	32,760	32,760
	Shuma			**365,160**

V:O Cmimet janë marrë sipas shkresës me Nr.Prot 565/8, datë 10.05.2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Prefekturës së Qarkut Shkodër në mungesë të konfirmimit të listes së çmimeve të mëvonshme.

Komisioni :

1. Kolë Ndrevashaj
2. Besmir Lekaj
3. Suad Mati
4. Administratori "Nj.Adm.Ana e Malit"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA EMERGJECAVE CIVILE

Shkodër, më 30.10.2026

MIRATOHET
KRYETARI
BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV. KRYETARI
ALBAN PREKA

Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtëpiake

Në mbështetje të VKM.nr. 329, datë 16.05.2012,"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" vlerësimi i dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për orenditë , mobiljet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në banesën e **Gjergj Nikolla** është:

Nr	Emertesa	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Dhomë gjumi matrimoniale	1	155,000	155,000
2	Komplet divane	1	41,400	41,400
3	Dyshek tek	1	7,600	7,600
4	Televizor LG 32	1	39,400	39,400
5	Tavoline buke	1	18,000	18,000
6	Karrige	4	1,400	5,600
7	Minibare	1	32,000	32,000
	Shuma			**299,000**

V:O Cmimet janë marrë sipas shkresës me Nr.Prot 565/8, datë 10.05.2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Prefekturës së Qarkut Shkodër në mungesë të konfirmimit të listes së çmimeve të mëvonshme.

Komisioni :

1. Kolë Ndrevashaj
2. Besmir Lekaj
3. Suad Mati
4. Administratori "Nj.Adm.Ana e Malit"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

ME VENDIM DELEGIMI
ZV. KRYETARI
ALBAN PREKA

MIRATOHET
KRYETAR
BENET BECI

Dt. 30.10.2026

PREVENTIV

Objekti: Banesë e dëmtuar nga zjarri Jak Nikolla

Vendndodhja: Muriqan-Shtuf, NJ.A Ana e Malit, BASHKIA SHKODER

Nr.	Nr. Anal.	Emertimi I Punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera/Leke
		1. Punime prishje				
33	An .	Prishje suvatim muri	m2	200.00	146	29,200
		Shuma 1	**Lek**			**29,200**
		2. Punime ndertimore				
1	226	Cati me tjegulla importi hd - 6 m	m2	85.00	4156	353,260
6	334	Suvatim I jashtem I zakonshem mur tulle	m2	130.00	919	119,470
3	310	Suvatim I brendeshem mure tulle , llac perzier	m2	180.00	617	111,060
20	276	Shtrese parketi laminat	m2	55.00	3134	172,370
8	An .	Tavan me veshje druri	m2	80.00	2583	206,640
9	265/a	Shtrese pllaka qeramike me kolle + llac cimento 1:2	"	25.00	1690	42,250
12	An .	F.V. dritare d/al. spesor 1.3 , dopio xham	"	10.00	9889	98,890
13	An .	F.V. dyer te brendeshme tamburato te thjeshta	"	5.90	9725	57,378
14	An .	Dyer te jashteme te blinduara veshur me rimeso	"	1.80	19700	35,460
15	405/a	Pragje dritaresh mermeri t = 2 cm.	"	3.5	3721	13,024
16	404 / 1	Lyerje me boje plastike brenda	"	130.00	150	19,500
		Shuma 2	**Lek**			**1,229,301**
		3. Punime Elektrike				
2	481/2	F.V. percjellesa PV - 500 2.5 mm2	ml	20.00	37	740
3	481/3	F.V. percjellesa PV - 500 4 mm2	"	6.00	54	324
4	480/1	F.V. tuba plastmasi Φ 14 - 17 mm	"	20.00	106	2,120
5	480/2	F.V. tuba plastmasi Φ 18 - 21 mm	"	8.00	116	928

6	483	F.V. priza te zakoneshme brenda murit 10 A	Cope	20.00	463	9,260
7	483	F.V. çelesa te zakoneshme brenda murit	"	15.00	417	6,255
9	487	F.V. kuti plastike çelesa e priza	"	20.00	102	2,040
10	An.	F.V. kuti plastike shperndarese PT2	"	2.00	208	416
11	486	F.V. Portollampa	"	6.00	198	1,188
13	An.	Koka fijesh S = 1.5 mm2	"	20.00	16	320
14	An.	Koka fijesh S = 2.5 mm2	"	15.00	20	300
15	An.	Kapak	"	2.00	80	160
		Shuma 3	**Lek**			**24,051**
		4. Punime H/ sanitare				
1	491	F.V. tub I xinguar 1/2 - 1 "	kg	12	398	4,776
2	494/1	F.V. saracineske bronxi 3/4 "	Cope	2	990	1,980
4	495	F.V. lavaman cilesi e II + grup	"	1	7993	7,993
5	499/1	F.V. lavapjete xingato me 1 govate + grup cilesi e II	"	1	7274	7,274
6	502	F.V. WC kasete plastike cilesi e II	"	1	8283	8,283
7	An.	Saricineske lavatrice	"	1	781	781
8	An.	Dalje bojleri	"	1	486	486
9	An.	Dalje bideje	"	1	486	486
10	515	Pilete xingato Φ 50 mm	"	1	1136	1,136
11	516	Tuba plastmasi Φ 100	ml	6	313	1,878
12	516	Tuba plastmasi Φ 50	"	15	291	4,365
		Shuma 4	Lek			**39,438**
		Totali				**1,321,990**

Preventivues:

Kole Ndrevashaj

Ing. Besmir Lekaj

Ark. Suad Mati

Administrator Lagjje/NJ. A

Shenim: Çmimet e perdorura jane " Cmimet sipas zerave te punes , per periudhen 2016 per Qytetin SHKODER te E.K.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

MIRATOHET
KRYETAR
BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV. KRYETARI
ALBAN PREKA

Dt. 30.10.2026

PREVENTIV

Objekti: Banesë e dëmtuar nga zjarri Gjergj Nikolla

Vendndodhja: Muriqan-Shtuf, NJ.A Ana e Malit, BASHKIA SHKODER

Nr.	Nr. Anal.	Emertimi I Punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera/Leke
		1. Punime prishje				
33	An .	Prishje suvatim muri	m2	100.00	146	14,600
		Shuma 1	**Lek**			**14,600**
		2. Punime ndertimore				
1	226	Cati me tjegulla importi hd - 6 m	m2	40.00	4156	166,240
6	334	Suvatim I jashtem I zakonshem mur tulle	m2	100.00	919	91,900
3	310	Suvatim I brendeshem mure tulle , llac perzier	m2	180.00	617	111,060
20	276	Shtrese parketi laminat	m2	55.00	3134	172,370
8	An .	Tavan me veshje druri	m2	80.00	2583	206,640
12	An .	F.V. dritare d/al. spesor 1.3 , dopio xham	"	10.00	9889	98,890
13	An .	F.V. dyer te brendeshme tamburato te thjeshta	"	5.90	9725	57,378
14	An .	Dyer te jashteme te blinduara veshur me rimeso	"	1.80	19700	35,460
15	405/a	Pragje dritaresh mermeri t = 2 cm.	"	3.5	3721	13,024
16	404 / 1	Lyerje me boje plastike brenda	"	130.00	150	19,500
		Shuma 2	**Lek**			**972,461**
		3. Punime Elektrike				
2	481/2	F.V. percjellesa PV - 500 2.5 mm2	ml	20.00	37	740
3	481/3	F.V. percjellesa PV - 500 4 mm2	"	6.00	54	324
4	480/1	F.V. tuba plastmasi Φ 14 - 17 mm	"	20.00	106	2,120
5	480/2	F.V. tuba plastmasi Φ 18 - 21 mm	"	8.00	116	928
6	483	F.V. priza te zakoneshme brenda murit 10 A	Cope	15.00	463	6,945

7	483	F.V. çelesa te zakoneshme brenda murit	"	10.00	417	4,170
9	487	F.V. kuti plastike çelesa e priza	"	15.00	102	1,530
10	An.	F.V. kuti plastike shperndarese PT2	"	2.00	208	416
11	486	F.V. Portollampa	"	6.00	198	1,188
13	An.	Koka fijesh S = 1.5 mm2	"	10.00	16	160
14	An.	Koka fijesh S = 2.5 mm2	"	10.00	20	200
15	An.	Kapak	"	2.00	80	160
		Shuma 3	**Lek**			**18,881**
		Totali				**1,005,942**

Preventivues:

Kole Ndrevashaj

Ing. Besmir Lekaj

Ark. Suad Mati

Administrator Lagjje/NJ. A

Shenim: Çmimet e perdorura jane " Cmimet sipas zerave te punes , per periudhen 2016 per Qytetin SHKODER te E.K.B.